

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.144 /2018	Data: 31.12.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, me propozim të Kryetarit të Komunës në mbledhjen e mbajtur më 31.12.2018 mori këtë:

V E N D I M PËR NDIHMË FINANCIARE FAMILJES SË POLICIT TË VRARË NË DETYRË

1. Anëtarët e Kuvendit të Komunës unanimisht miratuan Propozimin e Kryetarit të Komunës për ndihmën financiare familjes së Policit dhe Veteranit të ndjerë Izet Demaj që në mbrojtje të rendit dhe ligjit u vra me: 27.12.2018.
2. Kryetari i Komunës me mbështetjen e Kuvendit të Komunës ndanë shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro) familjes, e cila do t'i transferohet në xhirollogarinë e familjes- bashkëshortes së Izet Demaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet e Financa.

Me kopje të këtij vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bashkëshortja e të ndjerit Izet Demaj si dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna

Nr: 01-039-4 Data 29.01.2019
 Br: Datum

ISTOG-ISTOK



Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Qaush Balaj